



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

PROJEKT VENDIM

NR ____ DATË. ____ . ____ .2026

MIRATIMIN E LISTAVE NË KULLOTA VERORE E LIVADHE DHE KULLOTA NË PYJE
TË ULËT (cungishte) QË KULLOTEN PËR VITIN 2025

Në zbatim të Ligjit 9693 datë 19.03.2007 “ Për Fondin Kullor” të ndryshuar me disa ndryshime me Ligjin Nr.9996 datë 22.09.2008, si dhe për disa ndryshime dhe shtesa me Ligjin Nr. 49/2016, Udhezimi Nr. 2 datë 20.07.2016 “ Për Kriteret Teknike të Klasifikimit të Kullotave dhe Livadheve dhe Procedurave të Dhënies së Tyre Për Kullotje e Kositje Bari” kreu II pika 2 , Vendim Nr 467, date 31.7.2025 “ Për Miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje ose Kositje, Ligji Nr. 57/2020 “ Për Pyjet”. Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit. Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “ Për Vetqeverisjen Vendore”, Këshilli I Bashkisë ne mbledhjen e tij te dates ____ / ____ /2026.

VENDOSI

1. Miratimin e listave bashkangjitur për listat e kullotave verore dhe pyjeve që kulloten për vitin 2026.
2. Ky projekt-vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefektura.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit.

Konceptoi

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi

Petro KRISTO

NE MUNGESË DHE ME URDHER
NEN/KRYETAR

Petro RISTO

KRYETARI

Erion ISAI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E PYJEVE PARQEVE DHE REKREACIONIT

Nr 586 prot.

Ersekë më 22.01 . 2026

RELACION

(Për menaxhimin e kullotave verore për vitin 2026)

Një nga aktivitetet në fondin pyjor e kullësor nga Drejtoria e Pyjeve Parqeve dhe Rekreacionit pranë Bashkisë Kolonjë është dhe aktiviteti I kullotave verore , kjo ka një rëndësi të veçantë për Bashkinë duke theksuar faktin që zhvillimi i blektorisë për fermerët është prioritet në kushtet e jetesës si burim të ardhurash dhe bashkërenduar me politikat qeverisëse për ndihmë shtesë e shtim numerikut të tyre e sigurim për mbarështrim të qëndrueshëm .

Në zbatim të Ligjit 9693 date 19.03.2007 “ Për Fondin Kullësor” të ndryshuar me disa ndryshime me Ligjin Nr.9996 date 22.09.2008, si dhe për disa ndryshime dhe shtesa me Ligjin Nr. 49/2016, Udhezimi Nr. 2 datë 20.07.2016 “ Për Kriteret Teknike të Klasifikimit të Kullotave dhe Livadheve dhe Proçedurave të Dhënies së Tyre Për Kullotje e Kositje Bari” Vendim Nr 467, datë 31.7.2025 “ Për Miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje ose Kositje, kreu II pika 2, Vendimet e Këshillit Bashkiak për administrimin e kullotave, vendimet e të ardhurave, detyrat për miratim në Këshillin Bashkiak, mundësia e shfrytëzimit të kullotave për vitin 2026 hartohet ky relacion për mundësinë e shfrytëzimit të kullotave verore.

Kjo mundësi është e detajuar për çdo ekonomi kullësore (dhe kullotje në pyje sipas kërkesave) mbi të dhënat e planeve të mbarështrimit dhe inventarizimit të ekonomive kullësore (vitet 1980-1985 ish-rindermarja kullotave) prona bashkiake fond publik (kullota /pyje) sipas pasqyrave bashkangjitur ku shpjegohet: Nr i parces, sipërfaqja dobishme /padobishme , kapaciteti kullësor, nr kërësve të imta të trasha dhe tregues të tjerë teknike.

Mbështetur në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr138, dt 27.11.2025 (paketa fiskale vitit 2026) ndahet nga kufiri i kompetencave për kullotje dhe pagesa të tarifave përkatëse për Njesite Administrative dhe D.P,P .Rekreacion për komisionin e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për kullotë verore nga fermerët brenda dhe jashtë territorit të Bashkisë sipas specifikimeve Ligjore e n/ligjore.

Është i domosdoshëm miratimi i kullotjes në pyje (kryesisht pyjet e ulet të dushkut) e preferuar për të imtat si dhe çeltirat rreth fshatrave sidomos në zonat Cerçke, Sarandapor, Novosele, Barmash, Çlirim në funksion të plotësimit të kërkesave të fermerëve, realizimin e të ardhurave dhe uljes së informalitetit në pagesat e tarifave të kullotjes në kullota e pyje.

Për sa më sipër të dhënat e pasqyrave janë të përditësuara sipas kriterëve e metodikave të mbajtjes së kadastrës së pyjeve dhe kullotave dhe VENDIM Nr. 398, datë 13.5.2020 Per Disa Ndryshime në Vendimin Nr. 433, Date 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Per Trasferimin në Pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe Kullotave Publike Sipas Listave të Inventarit dhe Aktualisht në Administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkive”

Do të jemi të përkushtuar për rritjen e shkallës për mirëadministrimin e këtij aktiviteti.

Konceptoi
Specialisti I Kadastres dhe Kullotave

Ing. Ervin ÇUKA

Pranoi
Drejtori

Petro KRISTO

EKONOMIA KULLOSORE ÇLIRIM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA PYJE PAROE REKREACIONIT

Nr	Emeri i parcelës	Fshatit dhe Nr. Parces	Siperfaqeja ha		Tipi i kullotes		Aftesia mbajtese ne krere										
			Gjithesej E	E pa dobishme	Dimerore		Verore		Dimerore		Verore						
					E dobishme	E pa dobishme	E dobishme	E pa dobishme	Dhen	Dhi	Gjithesej	Dhen	Dhi	Te trasha	Gjith		
1	Shemitra	1	235.7	186.1	49.6			186.1	49.6				358	37			
2	Vreshtat Kaltanij	2	87.5	71.1	16.4			71.1	16.4				39	5	41		
3	Vilat	3	50	50				50					361	16			
4	Proi i Qesarakes	4	54	30	24			30	24				60	7			
5	Proi i Qesarakes	4a	4	4				4					24				
6	Lencke e vogel	5	74.7	74.7				74.7					196	2			
7	Shellirat e Lenckes	6	117.7	117.3	0.4			117.3	0.4				280	22			
8	Guri i Kamnikut	7	102	102				102					318	8	16		
9	Kisha e Kuqe	8	73	62.57	10.43			62.57	10.43				184	5	16		
10	Bregu i shureve	9	114.3	80.2	34.1			80.2	34.1				113	9			
11	Karunare	10	80.5	47.7	32.8			47.7	32.8				100	10			
12	Maja e shkembit	11	25	17.8	7.2			17.8	7.2					2	11		
13	Mbi Qyteze	12	45.5	32.3	13.2			32.3	13.2				110				
14	Lajthia e Mesickes	13	172	148.9	23.1			148.9	23.1				400		51		
15	Radom - Kurtes	14	65.6	46	19.6			46	19.6				260				
16	Bregu i viles	15	84	68.4	15.1			68.4	15.1				115	15	17		
17	Bregu i Demoves	16	158.5	131.4	27.1			131.4	27.1				355	6	20		

